4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

## 20. Konvertimi në valutë të vetme

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

## 21. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

### **Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:**

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një

ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$$

$P_o$  - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

$P_{k1}/P_{k2}/P_{k3}/\dots$  - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

**a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:**

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

$P_{k1}$  \_\_\_\_\_ Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{mink1}$  \_\_\_\_\_ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

$P_{maxk1}$  \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

**b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:**

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$$

$V_{maxk1}$  \_\_\_\_\_ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{maxk1}$  \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, autoritetet/entet kontraktore mund të përdorin kriteret e vlerësimit, si më poshtë:

## **Propozimi Teknik do të ketë 80 pikë**

### **Kriteret e Vlerësimit**

#### **Pikët**

**(i) Përvoja për Punë të Ngjashme të operatorit**

## **ekonomik**

### **Nënkriteret<sup>4</sup>**

#### **i/a Përvoja për punë të ngjashme**

Operatorët ekonomikë, mund të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

#### **i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë**

Operatorët ekonomikë mund të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

### **(ii) Metodologjia e Propozuar**

#### **Nënkriteret**

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit

ii.c. Organizimi i Stafit

**ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia:** Operatori ekonomik duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve, të paraqesin problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojnë për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, duhet të shpjegohet metodologjia që propozojnë të adoptojë dhe të paraqesin kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar, duke mos përsëritur/kopjuar Termat e Referencës

**ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:** Operatori ekonomik duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlikohen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në

---

<sup>4</sup> Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit nënkriterëve.

plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret.

**ii/c. Organizimi dhe Staf:** Operatori ekonomik duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e stafit të tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

**(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar**

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm

b. Eksperienca në fushën përkatëse

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

**2. Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:**

**Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë**

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

**Vlerësimi përfundimtar**

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

**Pesha për Propozimin Teknik: X = (pikët e propozimit teknik x 0.8)**

**pesha për Propozimin Ekonomik: Y = (pikët e propozimit ekonomik x 0.2)**

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

**Oferta më e mirë = X + Y**

**Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

**SHËNIM:** 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

**22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra,

ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

### **O - Oferta**

### **MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

##### **23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

##### **24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;

- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

#### **25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

#### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e

prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ entë kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Entë Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontratës;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

---

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					

---

<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

#### Shtojca 5.

---

(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

## **DEKLARATË**

### **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, *Deklaroj se:*

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt .....është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

---

<sup>6</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

## Shtojca 6.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**OBJEKTI:** *Për shërbimin e transportit të seteve sterile, seteve jo sterile, materialeve të buta sterile/jo sterile dhe mbetjeve të rrezikshme spitalore për nevojat e OSHIS sh.a.*

Referuar Vendimit Nr. 845, datë 30.12.2025 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e shoqërisë aksionare "Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit" sha (oshis sh.a.) për ofrimin e shërbimeve të integruara të procesit të sterilizimit" pika 2, Shoqëria aksionare

---

“Operatori i Shërbimit të Integruar të Sterilizimit” ofron, kundrejt pagesës, shërbimet e mëposhtme:

- a) ofrimin e seteve të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile;
- b) furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale;
- c) trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale;
- ç) menaxhimin dhe administrimin e Stacionit Qendror të Sterilizimit në QSUT;
- d) ofrimin e instrumenteve kirurgjikale sipas tipologjisë së ndërhyrjes, të paketuara në set individual për çdo pacient;
- dh) menaxhimin e cikleve për ripërpunimin dhe sterilizimin e instrumenteve dhe të materialeve të tjera të ripërdorshme;
- e) ripërpunimin e sterilizimin me avull dhe temperatura të ulëta;
- ë) furnizimin me veshje sterile salle dhe materiale të ngjashme njëpërdorimshme;
- f) trajtimin e mbetjeve spitalore me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e ambienteve;
- g) digjitalizimin e menaxhimit, të ndjekjes dhe të raportimit të shërbimeve të integruara të sterilizimit.

Në zbatim të VKM-së së sipërcituar, shoqëria ka detyrimin për ofrimin e këtyre shërbimeve për 29 spitale publike në Republikën e Shqipërisë, për të cilat është e nevojshme që në vijimësi të kryhet transporti i seteve sterile, seteve jo sterile, materialeve të buta sterile, materialeve të buta jo sterile, mbetjeve të rrezikshme spitalore që gjenerohen nga ky shërbim.

## BAZA LIGJORE

Ligji nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;

Vendimi Nr. 232, datë 01.04.2026 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kërkesave, procedurave dhe standardeve për menaxhimin e mbetjeve spitalore”;

Ligji nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”;

Marrëveshja Evropiane ADR për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme;

Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi për transportet rrugore;

Legjislacioni në fuqi për licencimin, lejet/autorizimet mjedisore, sigurinë në punë dhe prokurimin publik.

## PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT

Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimin të plotë, duke përfshirë:

- marrjen, ngarkimin, transportin dhe dorëzimin e seteve sterile dhe jo sterile, materialeve të konsumit sterile dhe jo sterile drejt centraleve të sterilizimit/depozitave pranë sallave operatore;
- grumbullimin e koshave/kontejnerëve me mbetje të rrezikshme spitalore të gjeneruara nga shërbimi i integruar i sterilizimit nga sallat operatore dhe transportimin drejt pikës së trajtimit të përcaktuar nga OSHIS sh.a. (Qendra e Logjistikës);
- zëvendësimin në momentin e tërheqjes të koshave/kontejnerëve të mbushur me kosha/kontejnerë të rinj, të pastër, të gatshëm për përdorim;
- sigurimin e integritetit, pastërtisë, mbylljes dhe etiketimit të koshave/kontejnerëve gjatë transportit;

- 
- ruajtjen e gjurmueshmërisë së lëvizjes me GPS, gjeofencing dhe raportim kilometrash për çdo mjet dhe çdo itinerar lëvizje.

**Shërbimi do të kryhet në funksion të plotë vajtje - ardhje, sipas itinerarit të miratuar dhe nevojave të shoqërisë OSHIS sha, konkretisht:**

- Mjeti merr nga Centralet e Sterilizimit setet me instrumenta kirurgjikalë të sterilizuara dhe i transporton drejt Depozitave të Sallave Kirurgjikale pranë Spitaleve sipas itinerarit të miratuar dhe nevojave të shoqërisë OSHIS sha.
- Mjeti merr nga Spitalet setet me instrumenta kirurgjikalë të përdorura në operacione dhe mbetjet e rrezikshme sitalore të gjeneruara nga shërbimi i integruar i sterilizimit dhe i transporton në Centralin e Sterilizimit dhe pikën e grumbullimit të mbetjeve të përcaktuar nga OSHIS sha ose pranë pikës së trajtimit të tyre.
- Në kthim mjeti merr nga magazina qendrore materiale sterile një përdorimshe dhe josterile, materiale konsumi dhe i transporton drejt Centraleve të Sterilizimit dhe Depozitave të Sallave Operatore;

#### KËRKESA TË DETYRUESHME PËR OPERATORIN EKONOMIK

- Të jetë i pajisur me licencë të vlefshme për veprimtarinë objekt kontrate.
- Të disponojë çdo leje, licencë ose autorizim tjetër të kërkuar nga legjislacioni në fuqi për transportin/grumbullimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.
- Të kryejë shërbimin me mjete të përshtatshme dhe të dokumentuara për transportin e mbetjeve të rrezikshme spitalore dhe të materialeve objekt shërbimi.
- Të disponojë çdo leje, licencë ose autorizim tjetër të kërkuar nga legjislacioni në fuqi për transportin e mallrave.
- Të disponojë sistem GPS funksional për çdo mjet, me akses për OSHIS sh.a. dhe raportim të plotë të kilometrave të shërbimit.
- Të përfshijë në koston e ofertës dezinfektuesit, pajisjet mbrojtëse dhe çdo material tjetër ndihmës të nevojshëm për transportin.

#### KËRKESAT QË DUHET TË PËRMBUSHIN MJETET E TRANSPORTIT TË MBETJEVE SPITALORE

1. Çdo automjet që transporton mbetje spitalore të rrezikshme duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

a) të jenë të pajisur me pajisje mekanike (pedanë) për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e koshave/kontejnerëve të mbetjeve spitalore dhe karrelave të instrumentave, duke siguruar kontakt minimal të njeriut me kontejnerët;

b) të jetë lehtësisht i identifikueshëm gjatë transportimit të mbetjeve me simbolin dallues ndërkombëtar të rrezikut të mbetjes spitalore që transportohet; simboli sipas përshkrimit më lart, nuk duhet të jetë më i vogël se 250 mm me 250 mm;

c) të ketë një panel paralajmërues, të vendosur dukshëm në pjesën e përparme dhe të pasme të automjetit për të treguar transportin e mbetjeve spitalore;

ç) paneli paralajmërues i rrezikut (varianti A ose B më poshtë) duhet të jetë në pjesën e përparme dhe të pasme të automjetit të transportit të mbetjeve spitalore në një pozicion që nuk mbulon asnjë dritë, targën ose shënime apo shenja të tjera të kërkuara ligjërisht; të dyja variantet janë të pranueshme dhe zgjedhja varet kryesisht nga hapësira në dispozicion;

d) të mirëmbahen në gjendje të mirë fizike dhe teknike.

Specifikimet:

- Materiali: metal ose material tjetër ekuivalent (1-2 mm e trashë);
- Veshjet: sfond reflektues
- Ngjyrat: konturi– i zi, sfondi– i verdhë, fjalët– të zeza;
- Përmasat fjalët  $\geq 40$  mm në lartësi;
- Pjata (versioni A): gjatësia  $\geq 200$  mm; gjerësia  $\geq 750$  mm;
- Pjata (versioni B): gjatësia  $\geq 340$  mm; gjerësia  $\geq 500$  mm.



2. Të ketë një ndarje midis kabinës së shoferit dhe trupit të automjetit, për të parandaluar kontaktin e personelit me ndotjen që mund të krijohet nga mbetjet spitalore gjatë transportit.

3. Pjesa ngarkues-transportues duhet të jetë e mbyllur dhe e siguruar në çdo kohë, përveç rasteve të ngarkimit dhe të shkarkimit të mbetjeve spitalore të gjeneruara nga shërbimi i integruar i sterilizimit, me qëllim parandalimin e hyrjes së paautorizuar, të ekspozimit ndaj kushteve atmosferike dhe të përhapjes së ndotjeve, apo erërave të pakëndshme në mjedis.

4. Të jetë i pajisur me një sistem të përshtatshëm për sigurimin e ngarkesës gjatë transportit në mënyrë që kontejnerët të mos lëvizin, përmbysen ose dëmtohen gjatë lëvizjes dhe të jetë projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos lejojë derdhjet e mbetjeve.

---

5. Të jetë i pastruar dhe dezinfektuar para çdo përdorimi, pas çdo derdhje ose ndotje brenda automjetit, dhe në çdo rast jo më pak se një herë në javë.

6. Gjatë transportimit të mbetjeve spitalore të rrezikshme, automjetet duhet të jenë të pajisura me veshje personale mbrojtëse për personelin, si dhe me pajisje dhe materiale për dekontaminimin, pastrimin dhe menaxhimin e situatave emergjente.

7. Mejtë të jetë furgon i mbyllur integral me peshë mbajtëse malli nga 1-1.5 ton për të përballuar ngarkesat e ditës si mbetje spitalore, karrelo me sete instrumenta kirurgjikale dhe materiale si sete sterile dhe josterile dhe materiale konsumi. Të ketë 4 dyer, ku dyert e pasme të jenë pa xham.

#### KËRKESA PËR SHOFERËT DHE PERSONELIN

- Shoferët duhet të jenë të trajnuar për, ngarkim-shkarkimin e koshave/kontejnerëve, karrelave të instrumentave, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, veprimet në rast rrjedhjeje/aksidenti dhe dokumentimin e shërbimit.
- Personeli duhet të përdorë gjatë shërbimit doreza, maska, çizme/pantofla pune, përparëse/veshje mbrojtëse, syze ose pajisje të tjera sipas natyrës së rrezikut.

#### NDARJA E NGARKESAVE DHE PARANDALIMI I KONTAMINIMIT

- Materialet sterile duhet të transportohen në kushte që ruajnë integritetin e ambalazhit, pastërtinë dhe mbrojtjen nga lagështira, dëmtimet dhe kontaminimi.
- Materialet sterile nuk duhet të transportohen njëkohësisht në të njëjtën hapësirë me mbetje spitalore ose materiale të kontaminuara.
- Mjetet që kanë transportuar mbetje spitalore duhet të pastrohen dhe dezinfektohen përpara çdo përdorimi tjetër të lejuar.

#### GPS, GJEOFENCING DHE RAPORTIM KM

Çdo mjet duhet të jetë i pajisur me GPS aktiv dhe të gjurmueshëm gjatë gjithë kohës së shërbimit. Operatori ekonomik duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor/OSHS sh.a. akses monitorimi në sistemin GPS, në kohë reale dhe në historikun e lëvizjeve, për të mundur kontrollin e kontratës, verifikimin e itinerareve dhe kontrollin e kilometrave të kryera brenda shërbimit. Operatorit ekonomik i kërkohet të konfigurujë itineraret në sistem me gjeofencing, sipas itinerareve të miratuara nga OSHS sh.a.

- Sistemi GPS duhet të japë pozicionin në kohë reale, targën e mjetit, historikun e lëvizjes, kilometrat, oraret, ndalesat.
- Operatori ekonomik nuk duhet të kufizojë aksesin e AK-së në monitorim, historik, eksportim raportesh dhe verifikim të kilometrave.
- Raportet GPS duhet të jenë të eksportueshme në Excel/PDF ose format tjetër të pranueshëm nga OSHS sh.a.
- Çdo itinerar duhet të gjenerojë raport ditor dhe, me përfundimin e muajit, raport mujor të kilometrave për muajin paraardhës.
- Raporti i kilometrave duhet të ndahet sipas mjetit, datës dhe itinerarit.

- 
- Në fund të çdo muaji, operatori ekonomik dorëzon pranë AK-së raportet mujore të kilometrave të kryera brenda shërbimit për çdo itinerar.
  - Për pagesën/pranim e shërbimit njihen vetëm kilometrat e kryera brenda shërbimit dhe brenda itinerareve/gjeofence të miratuara.
  - Çdo ndryshim nga itinerari bëhet vetëm me kërkesën/miratimin e OSHIS sha, dhe duhet të shoqërohet me arsyetim dhe dokumentim; devijimet e pajustificuara nuk pranohen si kilometra shërbimi.

### **Pagesa do të bëhet për km brenda shërbimit.**

#### **PASTRIMI DHE DEZINFEKTIMI**

- Mjetet që përdoren për mbetje spitalore duhet të pastrohen dhe dezinfektohen pas çdo cikli transporti ose sa herë ka rrjedhje, dëmtim ambalazhi, ndotje apo incident.
- Operatori duhet të mbajë regjistër të pastrimit/dezinfektimit me datën, orën, mjetin/koshin, personin përgjegjës dhe mënyrën e dezinfektimit.
- Dezinfektimi nuk zëvendëson detyrimin për ambalazhim, etiketim dhe transport të sigurt.

#### **SIGURIA DHE EMERGJENCAT**

- Operatori duhet të ketë plan emergjence për aksident, rrjedhje, dëmtim ambalazhi, ndotje, defekt teknik, bllokim rruge, ekspozim të personelit dhe vonesë të paplanifikuar.
- Mjeti duhet të ketë pajisje për izolimin e rrjedhjeve, materiale absorbente/dezinfektuese, sinjalistikë emergjence dhe pajisje mbrojtëse.
- Çdo incident i lidhur me mbetjet spitalore duhet t'i njoftohet menjëherë OSHIS sh.a. dhe, kur kërkohet, autoriteteve kompetente.
- Operatori duhet të garantojë mjet zëvendësues dhe shofer zëvendësues për të shmangur ndërprerjen e shërbimit.

#### **PRANIMI I SHËRBIMIT**

Shërbimi pranohet vetëm nëse:

- është kryer sipas itinerarit/gjeofence të planifikuar si dhe për çdo ndryshim të grafikut të itinerarit të miratuar paraprakisht nga OSHIS sha,
- është dokumentuar me GPS në kohë reale dhe me historik të verifikueshëm, është shoqëruar me dokumentet përkatëse të dorëzimit, raportet javore dhe mujore të kilometrave,
- janë respektuar kërkesat dhe nuk ka mangësi të pazgjdhura në raportin e OSHIS sh.a,
- AK konfirmon rrugët e kryera me Përgjegjësit e Depove të Sallave Kirurgjikale dhe Centralet e Sterilizimit, si dhe me Sektorin e Trajtimit të Mbetjeve, përpara pranimin dhe faturimit të shërbimit.

#### **KONFIGURIMI I GPS/GJEOFENCING BËHET SIPAS ITINERAREVE TË PLANIFIKUARA DHE SIPAS MIRATIMIT PARAPRAK TË OSHIS SH.A.**

## Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: *Shërbim rezervë (Back-Up) për sigurimin e vazhdimësisë së transportit të seteve dhe materialeve të konsumit sterile dhe jo sterile, transportit të mbetjeve të rrezikshme spitalore që krijohen nga seti i personalizuar, në pamundësi të përkohshme të "OSHIS" sha.*

#### Afatet e ekzekutimit:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia në muaj	Afati
1	<i>Shërbim rezervë (Back-Up) për sigurimin e vazhdimësisë së transportit të seteve dhe materialeve të konsumit sterile dhe jo sterile, transportit të mbetjeve të rrezikshme spitalore që krijohen nga seti i personalizuar, në pamundësi të përkohshme të "OSHIS" sha</i>	km	<b>46,006.67</b>	24 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër

---

## Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti: *“Shërbim rezervë (Back-Up) për sigurimin e vazhdimësisë së transportit të seteve dhe materialeve të konsumit sterile dhe jo sterile, transportit të mbetjeve të rrezikshme spitalore që krijohen nga seti i personalizuar, në pamundësi të përkohshme të “OSHS” sha”.*

Qëllimi i kontratës është sigurimi i një shërbimi të pandërprerë, të gjurmueshëm, të dokumentuar dhe të kontrolluar për transportin e seteve sterile, seteve jo sterile, materialeve të buta sterile, materialeve të buta jo sterile, materialeve të konsumit dhe mbetjeve të rrezikshme spitalore që gjenerohen nga aktiviteti i OSHIS sh.a. në institucionet shëndetësore publike.

Shërbimi duhet të garantojë ruajtjen e integritetit të materialeve sterile, shmangien e kontaminimit të kryqëzuar, transportimin e mbetjeve spitalore vetëm në kushte të sigurta, mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit, si dhe raportimin objektiv të itinerareve dhe kilometrave të kryera.

#### OBJEKTI I SHËRBIMIT

Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimin të plotë, duke përfshirë:

- marrjen, ngarkimin, transportin dhe dorëzimin e seteve sterile dhe jo sterile, materialeve të konsumit sterile dhe jo sterile drejt centraleve të sterilizimit/depozitave pranë sallave operatore;
- grumbullimin e koshave/kontejnerëve me mbetje të rrezikshme spitalore të gjeneruara nga shërbimi i integruar i sterilizimit nga sallat operatore dhe transportin drejt pikës së trajtimit të përcaktuar nga OSHIS sh.a. (Qendra e Logjistikës);
- zëvendësimin në momentin e tërheqjes të koshave/kontejnerëve të mbushur me kosha/kontejnerë të rinj, të pastër, të gatshëm për përdorim;
- sigurimin e integritetit, pastërtisë, mbylljes dhe etiketimit të koshave/kontejnerëve gjatë transportit;
- ruajtjen e gjurmueshmërisë së lëvizjes me GPS, gjeofencing dhe raportim kilometrash për çdo mjet dhe çdo itinerar lëvizje.

**Shërbimi do të kryhet në funksion të plotë vajtje - ardhje, sipas itinerarit të miratuar dhe nevojave të shoqërisë OSHIS sha, konkretisht:**

- Mjeti merr nga Centralet e Sterilizimit setet me instrumenta kirurgjikale të sterilizuara dhe i transporton drejt Depozitave të Sallave Kirurgjikale pranë Spitaleve sipas itinerarit të miratuar dhe nevojave të shoqërisë OSHIS sha.

- Mjeti merr nga Spitalet setet me instrumenta kirurgjikalë të përdorura në operacione dhe mbetjet e rrezikshme sitalore të gjeneruara nga shërbimi i integruar i sterilizimit dhe i transporton në Centralin e Sterilizimit dhe pikën e grumbullimit të mbetjeve të përcaktuar nga OSHIS sha ose pranë pikës së trajtimit të tyre.
- Në kthim mjeti merr nga magazina qendrore materiale sterile një përdorimshe dhe josterile, materiale konsumi dhe i transporton drejt Centraleve të Sterilizimit dhe Depozitave të Sallave Operatore;

#### KOHËZGJATJA DHE VENDI I ZBATIMIT

Afati i zbatimit të kontratës do të jetë 24 muaj. Shërbimi do të realizohet në të gjithë territorin ku OSHIS sh.a. kryen shërbime të integruara të sterilizimit dhe menaxhimit të mbetjeve spitalore sipas grafikut të shërbimit të planifikuar, si dhe për çdo rast të ndryshimit të grafikut të itinerarit të miratuar paraprakisht nga OSHIS sha.

#### ITINERARET DHE KILOMETRAT E PLANIFIKUARA

Itineraret dhe kilometrat e mëposhtëm janë marrë nga planifikimi operacional i transportit dhe shërbejnë si bazë teknike për konfigurimin e shërbimit, GPS dhe gjeofencing. Itineraret mund të ndryshojnë sipas urdhrave të OSHIS sh.a. dhe nevojave reale operative.

<b>ITENERARET VAJTJE - ARDHJE</b>	<b>KM VAJTJE</b>	<b>KM VAJTJE ARDHJE</b>	<b>RRUGE NE JAVE</b>	<b>RRUGE NE MUAJ</b>	<b>KM MUAJ</b>
SHKODER- LEZHE -TRANZIT	90.1	180.2	3	13	2342.6
PUKE - TRANZIT (2 here ne muaj) në gadishmëri sipas nevojës	116.1	232.2		2	464.4
BURREL - DIBER -TRANZIT	195.9	391.8	3	13	5093.4
BURREL - DIBER -BULQIZE -TRANZIT (1 here ne muaj) në gadishmëri sipas nevojës	196.9	393.8		1	393.8
TRAUMA - TRANZIT	19.2	38.4	6	24	921.6
SARANDE - GJIROKATER- VLORE - LUSHNJE	252	504	3	13	6552
KORCE - POGRADEC- LIBRAZHD - LUSHNJE (Erseka në gadishmëri sipas nvojës)	194	388	3	13	5044
QSUT - MATERNITETI KOCO GLOZHENI- MARTENITETI MBRETERESHA GERALDINE - TRANZIT	25.7	51.4	6	24	1233.6
BERAT - FIER -LUSHNJE	87.7	175.4	3	13	2280.2
FIER - LUSHNJE	26.1	52.2	6	25.8	1346.76
ELBASAN- SANATORIUM - TRANZIT	62.8	125.6	6	24	3014.4
LUSHNJE-TRANZIT	66.9	133.8	3	13	1739.4
TROPOJE KUKES KRUIJE KAVAJE-DURRES - TRANZIT	353.1	706.2	3	13	9180.6
QSUT -NEURO; ONKOLOGJIA; FRANCEZI; PLASTIKA; PEDIATRIA	1.7	3.4	24	103.2	350.88
TRAUMA - URGJENCAT 2TC; URGJENCA	0.4	0.8	14	60.2	48.16

2T; PLANIFIKIMET					
TOTAL	1688.6	3377.2			40,005.80
KILOMETRA PER RASTE NEVOJE +15%					6,000.87
<b>KILOMETRA TOTALE PERFSHIRE KM PER RASTE NEVOJE</b>					<b>46,006.67</b>

DERGESA E MATERIALEVE STERILE- JOSTERILE, INSTRUMENTA DHE MATERILAE KONSUMI NGA TRANZIT POINT NE CENTRALE, SPITALE	
DITA	SPITALET - CENTRALET
E HENE	Burrel, Diber, Bulqize
	Shkoder, Lezhe, Puke
	Korce, Pogradec, Erseke, Librazhd
	Shefqet Ndroqi, Elbasan, Gramsh
	Durres, Kavaje, Kukes, Tropoje, Kruje, Rreshen
	Lushnje, Fier, Berat
	Nene Tereza, Mbreteresha Geraldine
	Vlore, Sarande, Gjirokaster
	Trauma
E MARTE	Shefqet Ndroqi, Elbasan, Gramsh
	Nene Tereza, Mbreteresha Geraldine
	Trauma
E MERKURE	Burrel, Diber, Bulqize
	Shkoder, Lezhe, Puke

	Korce, Pogradec, Erseke, Librazhd
	Shefqet Ndroqi, Elbasan, Gramsh
	Durres, Kavaje, Kukes, Tropoje, Kruje, Rreshen
	Lushnje, Fier, Berat
	Nene Tereza, Mbretresha Geraldine
	Vlore, Sarande, Gjirokaster
	Trauma
E ENJTE	Shefqet Ndroqi, Elbasan, Gramsh
	Nene Tereza, Mbretresha Geraldine
	Trauma
E PREMTE	Burrel, Diber, Bulqize
	Shkoder, Lezhe, Puke
	Korce, Pogradec, Erseke, Librazhd
	Shefqet Ndroqi, Elbasan, Gramsh
	Lushnje, Fier, Berat
	Nene Tereza, Mbretresha Geraldine
	Durres, Kavaje, Kukes, Tropoje, Kruje, Rreshen
	Vlore, Sarande, Gjirokaster
	Trauma
E SHTUNE	Shefqet Ndroqi, Elbasan, Gramsh
	Nene Tereza, Mbretresha Geraldine
	Trauma
E DIELE	Nene Tereza, Mbretresha Geraldine

	Trauma
--	--------

DITA	SPITALET
E Hënë	Burrel, Diber, Bulqize
	Shkoder, Lezhe, Puka
	Lushnje, Korçe, Pogradec, Erseke, Fier, Berat, Librazhd, Vlore, Sarandë, Gjirokaster
	Shefqet Ndroqi, Elbasani, Gramshi
	Nene Tereza, Mbretëresha Geraldinë, Koço Gliozhen
	Spitali Universitar i Traumës
E Martë	Nene Tereza, Mbretëresha Geraldinë, Koço Gliozheni
	Shefqet Ndroqi, Elbasani, Gramshi
	Durrës, Kruja, Kavaja, Kuksi, Rresheni, Bajram Curri
	Spitali Universitar i Traumës
E Merkurë	Burreli, Dibra, Bulqize
	Shkoder, Lezhe, Puke
	Lushnje, Korçe, Pogradec, Erseke, Fier, Berat, Librazhd Vlore, Sarandë, Gjirokaster
	Nene Tereza, Mbretëresha Geraldinë, Koço Gliozheni
	Shefqet Ndroqi, Elbasani, Gramshi
	Spitali Universitar i Traumës
E Enjte	Nene Tereza, Mbretëresha Geraldinë, Koço Gliozheni
	Shefqet Ndroqi, Elbasani, Gramshi
	Durrës, Kruja, Kavaja, Kuksi, Rresheni, Bajram Curri
	Spitali Universitar i Traumës
E Premte	Burreli, Dibra, Bulqize
	Shkoder, Lezhe, Puke

	Lushnje, Korce, Pogradec, Erseke, Fier, Berat, Librazhd, Vlore, Sarande, Gjirokaster
	Nene Tereza, Mbretëresha Geraldinë, Koço Gliozheni
	Shefqet Ndroqi, Elbasani, Gramshi
	Spitali Universitar i Traumës
E Shtunë	Nene Tereza, Mbretëresha Geraldinë, Koço Gliozheni
	Shefqet Ndroqi, Elbasani, Gramshi
	Durresi, Kruja, Kavaja, Kuksi, Rresheni, Bajram Curri
	Spitali Universitar i Traumës
E Diel	Spitali Universitar i Traumës
	Nene Tereza, Mbretëresha Geraldinë, Koço Gliozheni

**QSUT -NEURO; ONKOLOGJIA; FRANCEZI; PLASTIKA; PEDIATRIA; BLOKU I RI;  
KARDIOKIRURGJIA; KIRURGJIA VASKOLARE;**

Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
E Hene -E Premte	8	40	Neuro, Onkologjia, Francezi, Plastika, Pediatria, Blloku i ri, Kardiokirurgjia, Kirurgjia vaskolare
E Shtune - E Diele	2	4	Neuro, Onkologjia, Francezi, Plastika, Pediatria, Blloku i ri, Kardiokirurgjia, Kirurgjia vaskolare

**QSUT – SPITALI “MBRETËRESHA GERALDIN”**

Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
E Hene- E Diele	2	14	Obstertika, Gjinekologjia

**TRAUMA**

Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT

E Hene- E premte	7	35	Urgjencat 2TC; Urgjenca TC; Planifikimet
E Shtune - E Diele	3	6	Urgjencat 2TC; Urgjenca TC; Planifikimet

SHKODER – LEZHE (DHE ANASJELLTAS)			
Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
E Hene - E premte	1	5	Urgjenca;Plaifikimet; Mikrokirurgjia; Materniteti

SHKODER - PUKE (DHE ANASJELLTAS)			
Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
Në gadishmëri sipas nevojave E hene, E merkure, E premte	1	3	Planifikimet; Obstetrika;Mikro Kirurgjia

SPITALI SHEFQET NDROQI - GRAMSH - SPITALI SHEFQET NDROQI			
Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
Në gadishmëri sipas nevojave E Hene,E Merkure, E Premte	ON CALL	3	Obsteri -Gjinekologji; Abortari;Planifikimet;Mikrokirurgji

SPITALI SHEFQET NDROQI - ELBASAN - SPITALI SHEFQET NDROQI			
Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
E Hene - E shtune	1	6	Obsteri -Gjinekologji; Abortari;Planifikimet;Mikrokirurgji

**GJIROKASTER – LUSHNJE - GJIROKASTER**

Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
E Hene -Merkure- E Premte	1	3	Salla Operatore; Mikrokirurgjia;Obstetrika;Gjinekologjia

**SARANDE – LUSHNJE - SARANDE**

Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
E Hene E Merkure E Premte	1	3	Salla Operatore; Mikrokirurgjia;Obstetrika; Abortar; Gjinekologjia

**KORCE – LUSHNJE -KORCE**

Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
E Hene; E Merkure; E Premte	1	3	

**POGRADEC– LUSHNJE - POGRADEC**

Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
E Hene E Merkure E Premte	1	3	Obstetrike;Planifikimet;Micro;Gjinekologji

**ERSEKE – LUSHNJE- ERSEKE**

Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
E Hene E Merkure E Premte Në gadishmëri sipas nevojave	1	3	Planifikimet; Obstetrika;Mikro Kirurgjia

**LIBRAZHD – LUSHNJE -LIBRAZHD**

Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
E Hene E Merkure E Premte	1	3	Obs- Gjinekologji, Abortari; Planifikimet;Mikrokirurgji

**LUSHNJE- FIER-LUSHNJE**

Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
E Hene – E premtë	2	10	Salla Operatore;Mikrokirurgjia;Obstetrika;Abortar Gjinekologjia
E shtune - E diel	1	2	Operatore;Mikrokirurgjia;Obstetrika;Abortar Gjinekologjia

**LUSHNJE – BERAT - LUSHNJE**

Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
E Hene – E premtë	2	10	Salla Operatore;Mikrokirurgjia;Obstetrika;Abortar Gjinekologjia
E Diel	1	1	

**DIBER – BULQIZE - DIBER**

Dita	NR ORAREVE	NR RRUGE NE JAVE	KLINIKAT
